

1. Dokumentacioni i kërkuar për anëtarësim dhe ndryshimet në vazhdim plotësohet nga vetë personi dhe dorëzohet pranë Këshillit Rajonal përkatës.
2. Kryesia e Këshillit Rajonal shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e kandidatit në të dy rastet e lartpërmendura dhe, kur gjykon se çdo gjë është konform rregullave në fuqi, ia përcjell zyrës qendrore të Urdhrit.
3. Dokumentacioni origjinal dërgohet pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit, nga Presidenti i Këshillit Rajonal.
4. Zyra Qendrore pranon dokumentacionin dhe ia përcjell për shqyrtim dhe miratim “ Komisionit të Rregjistrimit dhe Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit” i ngritur me Urdhër të Presidentit të UFSH-së. “Komisioni i Rregjistrimit dhe Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit” mbledhet jo më pak se 4 herë në muaj.
5. Farmacisti tërheq personalisht pranë Zyrës qendrore të UFSH Çertifikatën e Anëtarësimit dhe Kartën e Anëtarësimit.

#### **Ankimi për refuzimin e anëtarësimit**

Ndaj vendimit, që refuzon kërkesën për anëtarësim e regjistrim, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes dhe marrjes së njoftimit për vendimin. Këshilli Kombëtar e shqyrton atë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e ankesës. Ky vendim është i formës së prerë. Kërkuesi ka të drejtë t’i drejtohet Këshillit Rajonal përsëri me kërkesë vetëm 6 muaj pas përgjigjes negative të Këshillit Kombëtar, vetëm nëse ka plotësuar kriteret e duhura për anëtarësim.